



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 5293/prot.

Tiranë, më 27.08.2025

URDHËR

Nr. 420, datë 27.08.2025

PËR

**DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË URDHRI NR. 31, DATË 28.01.2020,
“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR FUNKSIONIMIN E
INSTITUCIONEVE ARSIMORE PARAUNIVERSITARE NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Shqipërisë, nenit 26 të ligjit nr. 69/12, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të urdhrit nr. 609, datë 20.12.2024 “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit znj. Orjana Osmani”,

URDHËROJ:

- I. Në Rregulloren për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, të miratuar me Urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020, të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për miratimin e Rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë:
 1. Në fund të nenit 2 shtohet shkurtimi “SMIP Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar.”
 2. Dy fjalitë e para të pikës 15 të nenit 3 ndryshohen me këtë përmbajtje:
“15. “Shkollë e arsimit bazë” është institucioni arsimor që drejtohet nga drejtori dhe në përbërje të saj mund të ketë:”
 3. Fjalja e parë e pikës 16 e nenit 3 ndryshohet me këtë përmbajtje:
“16. “Shkollë vartëse” është pjesë e një shkolle të arsimit bazë apo shkolle të bashkuar.”
 4. Pika 17 e nenit 3 ndryshohet me këtë përmbajtje:
“17. Shkolla e bashkuar është institucioni arsimor parauniversitar publik në të cilën përfshihen nxënës nga nivelet arsimore me kodet 1, 2, 3 ose vetëm disa prej tyre. Në këto shkolla mund të përfshihen edhe grupe të arsimit parashkollor. Mësimi në këto shkolla realizohet në një ose disa godina mësimore me vendndodhje të ndryshme.”

5. Në nenin 3, pas pikës 19 shtohen pikat 19.1. dhe 19.2., me këto përmbajtje:
- “19.1. “Shkollë me status të veçantë” është institucioni arsimor parauniversitar publik, i arsimit të orientuar me drejtim artistik dhe sportiv, i cili ka strukturë organizimi, kurrikul dhe mënyrë financimi të ndryshme nga IAPP-të.*
- 19.2. “Qendër Burimore” është institucioni i arsimit special, që ofron arsim special dhe shërbime të veçanta për fëmijët me aftësi të kufizuara.”*
6. Pika 6 e nenit 5 ndryshohet me këtë përmbajtje:
- “6. Regjistrimi i fëmijës në institucionet e arsimit parashkollor bëhet nga personi që ushtron përgjegjësinë prindërore sipas procedurave të përcaktuara nga NjVV-ja përkatëse.”*
7. Pikat 1, 2 dhe 4 të nenit 9 ndryshohen me këto përmbajtje:
- “1. Kurrikula në arsimin bazë mbështetet në këto dokumente: LAPU, Korniza Kurrikulare e arsimit parauniversitar, nivelet e arritjes, programet lëndore, urdhrat dhe udhëzimet e nxjerra nga ministria përgjegjëse për arsimin.*
- 2. Kurrikula e arsimit bazë është e organizuar në kurrikul bërthamë dhe kurrikul në bazë shkolle.*
- 4. Kurrikula në bazë shkolle është pjesë e kurrikulës së përgjithshme, zgjidhet nga shkolla dhe zhvillohet brenda kohës së planifikuar në planin mësimor, në përputhje me interesat, me nevojat e nxënësve dhe me mundësitë e shkollës.”*
8. Në nenin 10 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:
- “4. Plani vjetor dhe planet e periudhës janë dokumente zyrtare dhe objekt monitorimi/vlerësimi.”*
9. Neni 11 ndryshohet me këtë përmbajtje:
- “Neni 11 Hapja e klasave të arsimit të orientuar artistik dhe sportiv në arsimin bazë*
- Në shkollat e arsimit bazë krijohen klasa të arsimit të orientuar artistik/sportiv, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.”*
10. Pika 5 e nenit 16 ndryshohet me këtë përmbajtje:
- “5. Kurrikula në bazë shkolle fokusohet në zgjedhjen e lëndëve/moduleve që zhvillojnë prirjet dhe interesat e nxënësve, të cilat nuk zhvillohen në kurrikulën bërthamë.”*
11. Në nenin 18 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:
- “4. Plani vjetor dhe planet e periudhës janë dokumente zyrtare dhe objekt monitorimi/vlerësimi.”*
12. Pika 2 e nenit 19 ndryshohet me këtë përmbajtje:
- “2. Qëllimi kryesor i vlerësimit të arritjeve është nxitja e nxënësve për të përmirësuar rezultatet dhe nocionet e të nxënit.”*
13. Neni 20 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“Neni 20 Vlerësimi i nxënësit në arsimin parauniversitar

- 1. Vlerësimi i nxënësve bëhet sipas parashikimeve të udhëzimit përkatës të ministrisë përgjegjëse për arsimin, për vlerësimin e nxënësve në arsimin parauniversitar.*
- 2. Mësuesi mban të dhëna gjatë gjithë vitit shkollor për vlerësimin e nxënësit, sipas akteve ligjore në fuqi. Vlerësimi i vazhduar, testet/detyrat përmbledhëse dhe projekti kurrikular i nxënësit ruhen në shkollë dhe janë objekt monitorimi/vlerësimi në çdo periudhë të vitit shkollor.”*

14. Pika 1 e nenit 24 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“1. Veprimtaria në institucionet arsimore me kohë të plotë është 5 (pesë) ditë në javë dhe në ato me kohë të pjesshme 3 (tri) ditë në javë, nga e hëna deri të premten.”

15. Shkronjat “a)” dhe “b)” të pikës 2 të nenit 26 ndryshohen me këtë përmbajtje:

- “a) veprimtari social-kulturore, artistike, sportive, letrare, shkencore, mjedisore, edukim për karrierën;*
- b) ekskursione, vizita, konkurse dhe klube, që plotësojnë dhe zgjerojnë njohuritë e kurrikulës;”*

16. Neni 30 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“Neni 30 Njësia e Shërbimit Psiko-social

- 1. Njësia e Shërbimit Psiko-social (NjShPS) ngrihet sipas urdhrit për shërbimin psiko-social të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin.*
- 2. Detyrat, funksionet dhe përgjegjësitë e psikologëve dhe punonjësve socialë përcaktohen në udhëzuesin për praktikën e punës të shërbimit psiko-social shkollor, miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin.*
- 3. Numri i psikologëve dhe punonjësve socialë në NjShPS vendoset sipas urdhrit të ministrisë përgjegjëse për arsimin.*
- 4. Drejtuesi i NjShPS-së kryen këto detyra:*
 - a) harton planin vjetor të njësisë, i cili miratohet nga titullari i DRAP;*
 - b) organizon mbledhjet e njësisë;*
 - c) bashkëpunon me njësinë e mbrojtjes së fëmijëve, për të trajtuar çështje të abuzimit dhe të mbrojtjes së fëmijëve;*
 - ç) komunikon rregullisht me drejtorin e DRAP, të ZVAP-së, supervizorin e NJShPS-ës dhe me koordinatorin në DRAP, për çdo problematikë të këtij shërbimi, për një monitorim sa më të mirë të punës dhe për rritjen e cilësisë së shërbimit të ofruar;*
 - d) komunikon me drejtorin e DRAP dhe të ZVAP-së për rastet e fëmijëve në rrezik dhe me vështirësi sociale dhe ekonomike;*
 - dh) njofton me shkrim drejtorin e DRAP dhe të ZVAP-së për çdo rast të provuar apo të dyshuar për abuzimin e nxënës-it/-ve;*
 - e) mbikëqyr dhe mbështet veprimtaritë e psikologëve/punonjësve socialë të NJShPS-së përkatëse në bashkëpunim me supervizoret sipas nevojës dhe numrit të punonjësve të njësisë;*
 - ë) harton raporte vjetore për çdo vit shkollor për titullarin e DRAP, ku përshkruan veprimtarinë e NJShPS-së dhe propozon përmirësime të shërbimit psiko-social.*

17. Pika 4 e nenit 31 ndryshon me këto përmbajtje:
“4. Ndhmon mësuesit kujdestarë, mësuesit lëndorë dhe mësuesit ndihmës, për integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në klasat e IA-ve.”
18. Në nenin 31 shtohen pikat 8 dhe 9 me këto përmbajtje:
“8. Punonjësi i shërbimit psiko-social ofron shërbim në IA për nxënës, mësues dhe prindër për gjatë gjithë kohës kur shtrihet procesi mësimor dhe sa herë që është e nevojshme sipas udhëzimeve të miratuara. Në periudha kur ndërpritet procesi mësimor, punonjësit e shërbimit psiko-social angazhohen në veprimtari nga njësia e shërbimit psiko-social dhe në veprimtari për zhvillimin profesional në mënyrë që të ruhen standardet profesionale.
9. Punonjësi i shërbimit psiko-social njofton sipas protokolleve të miratuara personat që ushtrojnë përgjegjësitë prindërore. Gjithashtu personat që ushtrojnë përgjegjësitë prindërore i njofton nëpërmjet SMIP individualisht ose në grup për të gjithë nxënësit e klasës, me anë të "Fletores së komunikimit digjital", për t'i informuar ata, në kohë reale për nxënësit sipas detyrave dhe fushës së përgjegjësisë që mbulojnë.”
19. Pikat 1 e nenit 32 ndryshon me këto përmbajtje:
“1. Njësia e Shërbimit Psiko-social realizon zhvillimin e brendshëm profesional, sipas një plani vjetor të miratuar nga titullari i DRAP dhe zhvillimin e jashtëm profesional sipas akteve nënligjore në fuqi.”
20. Në nenin 33 pika 18 ndryshon me këtë përmbajtje:
“18. Zhvillon kontrolle fizike të nxënësve ose të mjediseve, sa herë vlerësohet e nevojshme në bashkëpunim me drejtorin e IA-së.”
21. Në nenin 33 shtohen pikat 19 dhe 20 me këto përmbajtje:
“19. Me miratim të drejtorit të shkollës, akseson sipas rastit kamerat dhe sistemet e sigurisë së institucionit, për të realizuar detyrat e tij funksionale.
20. Oficeri i sigurisë njofton sipas protokolleve të miratuara, personat që ushtrojnë përgjegjësitë prindërore. Gjithashtu personat që ushtrojnë përgjegjësitë prindërore i njofton nëpërmjet SMIP individualisht ose në grup për të gjithë nxënësit e klasës, me anë të "Fletores së komunikimit digjital", për t'i informuar ata, në kohë reale për nxënësit sipas detyrave dhe fushës së përgjegjësisë që mbulojnë.”
22. Pika 8 e nenit 44 ndryshohet me këtë përmbajtje:
“8. Institucioni arsimor ka të drejtë të aplikojë në strukturat përkatëse arsimore për pjesëmarrje në veprimtari shkencore, dhe projekte, si dhe të bashkëpunojë me programet evropiane të Erasmus +, për arsimin parauniversitar.”
23. Pika 1 e nenit 45 ndryshohet me këtë përmbajtje:
“1. Drejtori shkollës dhe mësuesi koordinator i sigurimit të cilësisë kanë për detyrë të hartojnë Planin e Zhvillimit Profesional tre vjeçar për mësuesit e shkollës dhe vlerësimin individual të nevojave për trajnim për mësuesit, të identifikuara nga monitorimi periodik

i kryer dhe nevoja për trajnim për mësuesit, i cili duhet të përcillet përmes SMIP në ZVAP, AKAP dhe ASCAP. Këto institucione duhet të përgatisin kalendarin e trajnimeve për planifikimin e tyre në programin e zhvillimit profesional të mësuesve të hartuar dhe zhvilluar nga ASCAP”

24. Neni 46 ndryshon me këtë përmbajtje:

“Neni 46 Vlerësimi i punës së drejtorit të institucionit arsimor

1. Vlerësimi i drejtorit të IA-së, bëhet nga ZVAP përmes strukturave në fund të çdo viti shkollor dhe dërgohet në DRAP deri në 15 gusht të vitit korrent. Vlerësimi është pjesë e dosjes së drejtorit.

2. Vlerësimi bazohet në standardet e performancës së drejtorit të shkollës të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin, në performancën e IA-së, si dhe në vlerësimin vjetor të Këshillit të Prindërve përmes një pyetësori standard në SMIP, i cili plotësohet në mënyrë digjitale nga anëtarët e Këshillit të Prindërve të IA-së, çdo muaj korrik të vitit korrent.”

25. Neni 48 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“Neni 48 Sekretari i institucionit arsimor

1. Sekretari i IA-së, kryen këto detyra:

a) sistemon dhe mirëmban arkivin e IA-së;

b) përgatit dokumentet që lëshon shkolla për nxënësit ose ish-nxënësit e saj;

c) vë në dijeni drejtorin e IA-së kur bën gabime në dokumentacion dhe ndreqja e tyre bëhet vetëm në praninë e drejtorit dhe të dy mësuesve, duke nënshkruar të gjithë një procesverbal ku shpjegohet korrigjimi;

c) merr dhe dërgon postën zyrtare;

d) asiston drejtorin e IA-së në përgatitjen e statistikave zyrtare sipas legjislacionit në fuqi;

dh) kryen çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga drejtori i IA-së, që lidhet me veprimtarinë e shkollës.”

26. Pika 1 e nenit 57 ndryshon me këtë përmbajtje:

“1. Punonjësi arsimor, psikologu, punonjësi social, oficeri i sigurisë dhe sekretari respektojnë rregulloren e IA-së dhe kodin përkatës të etikës.”

27. Pas shkronjës “b”, të pikës 3, të nenit 89, shtohet shkronja “c”, me këtë përmbajtje:

“c. Të vlerësojë në fund të çdo viti mësimor, performancën e drejtorit të shkollës.”

28. Pika 8 e nenit 89 ndryshon me këtë përmbajtje:

“8. Zgjedhjet për këshillin e prindërve të IA-së dhe për kryetarin e tij zhvillohen në fillim të vitit shkollor dhe janë me mandat dyvjeçar. Mandati i anëtarit dhe kryetarit të këshillit të prindërve ndërpritet, kur fëmija/ët e tij nuk janë më nxënës të institucionit arsimor.”

29. Shtojca 1 shfuqizohet.

II. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhri, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR

ORJANA OSMANI

